



RAPORT MONITORIMI PËR GJUHËN E URREJTJES NË SHQIPËRI

DORENTINA HYSA DHE KRISTINA LANI



Funded by
the European Union

B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

 **Norway**



Reporting
Diversity
Network 2.0

Titulli: Raport Monitorimi për gjuhën e urrejtjes në Shqipëri

Autorë: Dorentina Hysa dhe Kristina Lani

Botues: Instituti Shqiptar i Medias



K2.0



Rrjeti i Raportimit të Diversitetit 2.0 - RDN 2.0 është krijuar me qëllim për të ndikuar efektivisht raportimin në media të etnisë, fesë dhe gjinisë në Ballkanin Perëndimor.

Partnerët e projektit përfshijnë Institutin për Diversitet në Media (UK), Institutin Shqiptar të Medias, Qendra për Gazetari Investigative (BiH), Qendra për Gazetari Investigative Mali i Zi, Rrjeti Juglindor për Profesionalizimin e Medias (SEENPM), Instituti për Studime të Komunikimit (ICS), Kosovo 2.0, Instituti për Diversitet në Media (WB)

Projekti financohet nga Bashkimi Evropian, Trusti Ballkanik për Demokraci, projekt i Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë.



Funded by
the European Union



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND



Ky publikim është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian, Trustit Ballkanik për Demokraci, një projekt i Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe Raportimit të Rrjetit të Diversitetit 2.0 dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Trustit Ballkanik për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara, Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë apo partnerëve të tyre.



RAPORT MONITORIMI PËR GJUHËN E URREJTJES NË SHQIPËRI

DORENTINA HYSA DHE KRISTINA LANI

Përmbajtja

5	HYRJE
6	QASJA METODOLOGJIKE
7	NARRATIVAT DHE NËN-NARRATIVAT E GJUHËS SË URREJTJES DHE DISKRIMINUESE
7	Vështrim i përgjithshëm i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese në Shqipëri gjatë 2021
8	Diskursi i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese me bazë etninë
11	Diskursi i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese me bazë gjininë
12	Diskursi i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese me bazë orientimin seksual
14	ANALIZË KRAHASUESE
15	NISMAT KOMBËTARE PËR LUFTËN KUNDËR GJUHËS SË URREJTJES
16	PËRFUNDIME
17	REFERENCA

Hyrje

Ky raport vjetor paraqet situatën e përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese në mjedisin mediatic shqiptar. Raporti bazohet në monitorimin e mediave të kryer gjatë periudhës Janar 2021 – Prill 2022. Njësitë e monitorimit kanë qenë incidentet që përmbanin gjuhë urrejtjeje dhe diskriminuese të prodhuara, të shpërndara apo të lejuara të shpreheshin në media, përfshirë ato tradicionale, median e re dhe atë sociale.

Incidentet u identifikuan nëpërmjet përdorimit të fjalëve kyçe dhe monitorimit ditor të kanaleve të ndryshme mediatike. Incidentet e identifikua u analizuan dhe më pas u raportuan sipas formatit të raportimit të hartuar nga Prof. Snježana Milivojević. Në fokus të monitorimit kanë qenë incidentet që përmbanin gjuhë urrejtjeje që prekte individët, grupet ose komunitetet në bazë të gjinisë, përkatësisë etnike, fetare, orientimit seksual, si edhe emigrantët dhe refugjatët. Megjithatë, gjatë monitorimit u shfaqën kategori të reja, si për shembull personat me aftësi të kufizuara, persona të vdekur, gazetarë, kundërshtarët politikë etj., incidentet e të cilave u raportuan dhe janë përfshirë në këtë raport.

Gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese ka qenë më e përhapur ndaj grupeve, individëve dhe komuniteteve për shkak të përkatësisë etnike (38.5%), gjinisë (20.5%) dhe orientimit seksual (12%). Prej vitesh situata paraqitet e njëjtë për këto kategori dhe pavarësisht përpjekjeve të bëra nga organizatat mediatike dhe autoritetet e medias, gjendja vazhdon të jetë problematike. Një raport i monitorimit të medias¹ i publikuar në vitin 2021 ka nxjerrë se gratë dhe vajzat janë grupi më i prekur sa i përket gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese në internet, konstatim i cili konfirmohet edhe nga monitorimi² që Instituti Shqiptar i Medias (ISHM) ka bërë në vitin 2022, ku 81.8% e incidenteve preknin këtë grup.

Është hera e parë që gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese me sfond etnik mbizotëron, gjetje kjo në kundërshtim me raportet e tjera të monitorimit të publikuara më parë³. Megjithatë, mund të shpjegohet me kontekstin e zhvillimeve të fundit brenda vendit, si pritja e refugjatëve afganë dhe sirianë në Shqipëri, teoritë e konspiracionit lidhur me COVID-19 dhe ndikimi i tyre në qëndrimet ndaj popullit kinez dhe hebrejve, si edhe zhvillimet politike mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera. Një faktor tjetër kontribues është se në këtë kategori përfshihen edhe pakicat etnike në Shqipëri, përkatësisht komuniteti Rom dhe Egjiptian. Media kontribuon në diskursin e dëmshëm përmes përforsimit të paragjykimëve me bazë etnike, shkrimit të titujve që prekin një grup të tërë etnik edhe kur është vetëm një individ i përfshirë në ngjarje, si edhe duke lejuar përdoruesit në internet të postojnë komentet e tyre përcjues dhe me gjuhë urrejtjeje, pa i filtruar ato.

Sa i përket komunitetit LGBTQ+, ata bëhen subjekt i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese që ushqehet nga media përmes titujve sensacionalë dhe publikimit të informacione të paverifikuara, të cilat nxisin përdorimin e kësaj gjuhë nga ana e audiencës online. Raportimet mediatike lidhen me zhvillimet në vend, siç ishin diskutimet e vazhdueshme për familjen, të cilat prodhuan diskurs diskriminues dhe gjuhë urrejtje ndërmjet mbështetësve të komuniteteve LGBTQ+ dhe atyre që mbështesin familjen tradicionale, kryesisht komuniteteve fetare. Megjithatë, bazuar në matjen e intensitetit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese ndaj këtij minoriteti, vlera mesatare mbetet relativisht e ulët (2.1).

Pavarësisht pranisë shqetësuese të diskursit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese në median shqiptare dhe komunikimin publik, klasifikimi sipas analizës sentimentale tregon një rezultat mesatar të nivelit 3. Kjo do të thotë se ashpërsia e diskursit është e ndërmjetme dhe karakterizohet nga narrativa fyese, ofenduese, por jo të dhunshme. Megjithatë, kjo nuk e pakëson ndikimin negativ që këto narrativa përçarëse kanë tek individët, grupet dhe komunitetet e prekura, si edhe në të gjithë shoqërinë.

1 Historia Ime (2021). Monitorimi i Gjuhës së Urrëjtjes, diskriminuese dhe seksiste në mediat online dhe televizion. I aksesueshëm në: <https://www.historiaime.al/media/raport-monitorimi-i-medias-per-gjuhen-diskriminuese-dhe-seksiste-2021/>

2 ISHM (2022). Mind the Language. Project Handbook. I aksesueshëm në: <https://www.annalindhfoundation.org/sites/default/files/documents/network-news/Mind%20the%20Language%20-%20Project%20Handbook.pdf>

3 OSFA, ISHM. Prijet e gjuhës së urrejtjes në median shqiptare. Një monitorim i disa mediave të shkruara dhe online. I aksesueshëm në: https://www.osfa.al/sites/default/files/monitorimi_per_gjuhen_e_urrejtjes_ne_gazeta_dhe_media_online_3.pdf



Qasja metodologjike

Të dhënat për këtë raport u mbledhën në periudhën Janar 2021 – Prill 2022. Monitorimi i medias është bërë çdo javë për të identifikuar dhe raportuar raste të gjuhës së urrejtjes lidhur me gjininë, përkatësinë etnike, fenë, pakicat seksuale dhe migrantët/refugjatët.

Mbështetur në instrumentin e raportimit të hartuar për këtë qëllim, u mbledhën të dhëna për datën e publikimit të incidentit, vendin ku ka ndodhur, llojin e urrejtjes së identifikuar, përmbajtjen/narrativën e diskursit, autorin/ët e incidentit, mediat në të cilat u identifikua dhe përhapja e incidentit. Për rastet më të rënda janë përgatitur dhe publikuar reagime, të cilat përfshijnë artikuj, postime në median sociale, letra drejtuar redaktorëve dhe raportim të rasteve në platformat e mediave sociale.

Të dhënat e mbledhura u analizuan nga ana sasiore dhe cilësore. Analiza sasiore paraqet të dhëna në lidhje me frekuencën e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese për secilën kategori, ndërsa analiza cilësore përbëhet nga analiza narrative, analiza sentimentale dhe analiza e vizibilitetit, që së bashku ofrojnë një kuptim të thellë të incidenteve. Analiza e sentimentit bazohet në instrumentin e zhvilluar nga Universiteti George Washington⁴, i cili përdor një shkallë të matjes së intensitetit në 6 nivele, si më poshtë:

- 1. Mosmarrëveshje** – Retorikë që përfshin mospajtimin me idenë në nivel mendor, sfidimin e pretendimeve, ideve dhe besimeve të grupeve subjekt të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese ose përpjekjet për t'i ndryshuar ato.
- 2. Veprime negative** – Retorikë që përfshin veprime negative, jo të dhunshme, të lidhura me grupin që është subjekt i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese.
- 3. Karakter negativ** – Retorikë që përfshin karakterizime dhe ofendime jo të dhunshme të personit/grupit që është subjekt i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese.
- 4. Demonizimi dhe çnjerëzimi** – Retorikë që përfshin specifikimet e karakteristikave çnjerëzore (nënjjerëzore/mbinjerëzore) të individit/grupit të prekur.
- 5. Nxitja e dhunës** – Retorika nënkupton shkaktimin e dëmtimit fizik ose dëmtimit fizik të mundshëm, të dëshirueshëm.
- 6. Vdekja** – Retorika nënkupton vrasjen e mirëfilltë ose eliminimin e një grupi.

Qëllimi i këtij raporti kërkimor është të kontribuojë në kuptimin e modeleve të diskursit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit në media dhe komunikimin publik në Shqipëri, si edhe të rrisë aftësinë e shoqërisë për të reaguar dhe për të zhvilluar narrativa që promovojnë të drejtat e njeriut, diversitetin dhe tolerancën.


⁴ George Washington University (2019). Monitorimi i gjuhës së urrejtjes në mediat amerikane. Artikull. Projekti për median dhe krijimin e paqes, faqja 5. E disponueshme online në: [Monitoring-Hate-Speech-in-the-US-Media-3_22-20h5kk.pdf](https://www.gwu.edu/~iac/monitoring-hate-speech-in-the-us-media-3-22-20h5kk.pdf) (cpb-us-el.wpmucdn.com)

Narrativat e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese

1. Vështrim i përgjithshëm i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese në Shqipëri gjatë 2021


Për periudhën e raportimit të mbuluar në këtë raport, rastet më të përhapura të diskursit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese, siç tregohet në grafikun nr. 1, kanë të bëjnë me përkatësinë etnike (38.5%), gjininë/gratë dhe vajzat (20.5%) dhe pakicat seksuale (12.5%). Është interesante të theksohet se për herë të parë në monitorimin e mediave, përkatësia etnike tejkalon gjininë dhe kjo mund të lidhet fort me zhvillimet politike dhe sociale në vend gjatë periudhës së monitorimit..

Grafiku Nr.1. Tre subjektet kryesore të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese, 2021



Megjithatë, këto nuk janë kategoritë e vetme subjekt të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese. Siç shihet në grafikun nr. 2, gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese ka qenë e përhapur pothuajse në mënyrë të barabartë mes fesë (7.2%) dhe kundërshtarëve politikë (7.2%). Kjo pasohet nga gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese kundër emigrantëve/refugjatëve (6.2%), kategorive të tjera (4.8%) ku përfshihen personat me aftësi të kufizuara, personat e vdekur dhe gazetarët (2%). Një gjetje tjetër e rëndësishme është se ka një numër të konsiderueshëm incidentesh (25.30%) që prekin kategori të shumta, për shembull gratë, kundërshtarët politikë dhe përkatësinë etnike.

Grafiku Nr.2. Subjekte të tjera të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese, 2021



2. Diskursi i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese me bazë etninë

Prania e diskursit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese me bazë etnike nuk ka qenë kurrë kaq e pranishme në mjedisin mediatic shqiptar, të paktën bazuar në hulumtimet e disponueshme, të cilat kanë treguar mungesën e një diskursi të tillë në të kaluarën⁵. Megjithatë, monitorimi ynë mediatic për vitin 2021 tregon një prani të shtuar të diskursit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese me sfond etnik që mund të shpjegohet me serinë e ngjarjeve që ndodhën brenda vendit, në rajon, si dhe në kontekstin ndërkombëtar. Një nga ngjarjet që mund të ketë pasur ndikim në diskurs është pandemia COVID-19, e cila u shoqërua me teori konspirative, dezinformim dhe keqinformim, që i vendosi kinezët dhe hebrejtë në qendër të diskursit të urrejtjes dhe diskriminimit. Për shembull, këtu është titulli i një shkrimi në një gazetë online⁶ që përmban gjuhë urrejtjeje dhe diskriminuese:



“Pacienti me COVID në Sanatorium: Më mirë të vdesësh nga Zoti, se sa nga ata qen bir qensh, kinezët.”

Ngjarje të tjera nxitëse janë pritja e refugjatëve afganë dhe sirianë në Shqipëri, miratimi i ligjit nr. 79/2021 “Për të huajt”⁷ që rregullon hyrjen, qëndrimin dhe punësimin e të huajve nga vende si Bangladeshi, India dhe Maroku; rritja e vizitorëve nga Serbia, vendet arabe dhe aziatike; deklarata politike e një deputeti serb; evente muzikore, etj. Disa tituj dhe komente të audiencës pasqyrojnë frikën e “pushtimit” nga këta të huaj që perceptohen dhe raportohen si “të dhunshëm”, “hajdutë”, “agresivë” dhe madje në disa raste sikur po “rrëmbejnë mundësitë” nga duart e shqiptarëve apo edhe fajësohen për situata të caktuara. Ja një shembull i kësaj narrative, botuar në një gazetë⁸:



“...Në Shqipëri mund të hyjnë “dërrit dhe dosa”, klandestinë dhe emigrantë indianë, sirianë, afganë, bangladeshas, aziatik të cilët po sjellin me vete edhe virusin vdekjeprurës.”

Një bazë e përbashkët për të gjitha incidentet e evidentuara është se raportimi bëhet në bazë të paragjykimëve, stereotipeve dhe klisheve, të cilat në disa raste shkruhen si tituj që nxisin audiencën online të shprehë urrejtje në rubrikat e komenteve në portalet e lajmeve në internet dhe në rrjetet sociale. Kjo logjikë e raportimit përforcon ndarjet etnike mes “nesh” dhe “atyre”, ku zakonisht “ne” jemi të mirë dhe “ata” janë “të këqij”. Ja si mund të jetë e pranishme kjo ndarje në media, duke marrë për referencë raportimin që përfshin shqiptarët dhe grekët, ku vihen re dy modele: 1) modeli që i paraqet shqiptarët si superiorë dhe fitues ndaj grekëve⁹ dhe 2) modeli që portretizon shqiptarët si vrasës dhe kriminelë në krimet që ndodhin në Greqi¹⁰, edhe kur shqiptarët nuk janë të përfshirë fare.

Ky model është i pranishëm edhe në incidentet që përfshijnë shqiptarë dhe etni të tjera. Ekziston një rreth vicioz i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese në këtë drejtim, ku një rrëfim përshkruan njëri anë si “të mirë” dhe anën tjetër si “të keqe” në vendet përkatëse. Megjithatë, është interesant fakti se në mjaft raste shqiptarët janë në shënjestër të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese që vjen nga mediat shqiptare dhe vetë shqiptarët. Kjo është diçka që duhet hetuar më tej për të kuptuar motivet pas kësaj sjelljeje.

5 Instituti Shqiptar i Medias (2015) Prirjet e gjuhës së urrejtjes në median shqiptare, p. 7.

6 TemA (22 Shkurt 2021). “Pacienti me COVID në Sanatorium: Më mirë të vdesësh nga Zoti, se sa nga ata qen bir qensh, kinezët”. I aksesueshëm në: <https://www.gazetatema.net/2021/02/24/pacienti-me-covid-ne-sanatorium-me-mire-te-vdesesh-nga-zoti-se-sa-nga-ata-qen-bir-qensh-kinezet/>

7 Parlamenti i Republikës së Shqipërisë (2021). Ligji Nr. 79/2021 për të huajt. I disponueshëm në: <https://www.parlament.al/Files/Akte/2021070817284820210705135531ligji%20nr.%2079%20dt.%2024.6.2021.pdf>

8 Gazeta Telegraf (16 Shtator 2021). “Bota po mbyll kufijtë, Shqipëria “han pa porta”. I disponueshëm në: <https://telegraf.al/politike/bota-po-mbyll-kufijete-shqiperia-han-pa-porta/>

9 <https://youtu.be/L-Zdji0YkA4>.

10 <https://www.thesun.co.uk/news/14963780/fears-albanian-gang-tortured-brit-mum-death/>

Për shembull, një rrëfim kundër vetë shqiptarëve është rasti i një personi publik që thotë:



“Ky është komb fshatarësh! Jemi republikë ‘kollovarësh’”¹¹

Kur bëhet fjalë për gjuhën e urrejtjes dhe diskriminuese për këtë kategori, mbizotërojnë gazetarët/mediat, të ndjekur nga individët (nëpërmjet komenteve), politikanët, personazhet publikë dhe influencers. Mediat dhe gazetarët, pavarësisht se nuk janë autorë të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese, bëhen pjesë e saj duke riprodhuar ato që kanë thënë të tjerët pa e filtruar atë. Media nxjerr në pah diskursin e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese, duke publikuar tituj për klikime dhe sensacionale, që në shumicën e rasteve frymëzojnë komente me gjuhë urrejtjeje nga lexuesit, të cilat nuk filtrohen pavarësisht nga gjuha e urrejtjes që përmbajnë.

Një model tjetër që vihet re është se mediat shpesh, në shkelje të Kodit të Etikës së Gazetarisë, përmendin përkatësinë etnike kur në fakt nuk ka lidhje me ngjarjen, siç ndodhi në rastin e një turisteje që u kap duke vjedhur në një dyqan në Shqipëri, duke e fokusuar lajmin tek etnia e personit, gjë që nxiti përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese nga lexuesit. Prekja e një grupi të tërë etnik në vend të personit që kryen një akt, është i dëmshëm për të gjithë grupin dhe mban gjallë stereotipet negative që ndajnë njerëzit dhe bëhen bazë për gjuhën e urrejtjes, diskriminimin dhe përjashtimet në jetën reale.

Bazuar në analizën sentimentale, rezultati mesatar për të gjitha incidentet që lidhen me gjuhën e urrejtjes dhe diskriminuese me sfond etnik është 3, gjë që tregon se pavarësisht shpeshësisë së incidenteve, ato mbeten në objektivin e portretizimit të “të tjerëve” si personazhe negative dhe retorika përfshin karakterizime dhe fyerje jo të dhunshme. Megjithatë, tek incidentet ka pasur renditje të ndryshme nga 1-6, gjë që tregon një përzjerje rrëfimesh që nisnin nga mosmarrëveshja e deri tek më e ashpra, që është eliminimi fizik i një personi/grupi. Disa nga shembujt e kësaj retorike janë renditur në tabelën e mëposhtme:

Niveli	Gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese - Etnia
1-Mosmarrëveshje	“Sirianët shpërthejnë kufijtë shqiptarë”; “një rrezik i shtuar në kohë pandemie”; “shtet harixhinjësh”; “provokim i turpshëm”; “kthejini ata në vendin e tyre”; “Parti e çmendur nacionaliste”; “Pse nuk e gjobit UEFA këtë racë f***** që bën simbole raciste-nacionaliste?”; “Aktori zemëron grekët, thotë “me guxim” në shfaqje: Nuk dua mbiemër grek, jam krenar që jam shqiptar”, etj.
2-Veprime negative	“Armiku”; “Miq të e Turqisë”; “Qen bir qeni Kinez”; “Ky është një komb fshatar! Jemi republikë ‘kollovarësh’”; “Kosova është Serbi”; “Krime të tmerrshme u kryen kundër serbëve dhe kur të gjithë serbët u dëbuan për faj të Shqipërisë”; “Mos i kaloni pushimet verore në Shqipëri”; “E çuditshme...sepse këta supozohej të ishin ajka e shoqërisë afgane. Është e vërtetë se terrori rrjedh në gjakun e tyre.” etj.
3-Karakter/Personazh negativ	“F*ck Kosova”; “bij k*rvas”; “Piss serb”; “Idiot, shko gjej ndonjë cigan...I shkonte një cigan, se është i zi...”, etj.
4-Demonizimi & çnjerëzim	“Jevgjite” (cigan); “monstra”; “racë e keqe”; “bastardë”; “Karlomalavita”; “I sëmur mendor”; “Shpresojmë se ata nuk kanë kontraktuar ndonjë virus me mutacion në Bangladesh, sepse ata janë gjithashtu afër Indisë”; “Turistët që morëm” (përkundrejt turistëve që prisnim, duke nënkuptuar se janë turistë “të padëshirueshëm”); “i çoroditur” etj.
5- Nxitja e dhunës	“Valëvitet flamuri serb në qendër të Tiranës”: “Turp”; “Do të digjet në flakë”; “Policia beson se shqiptarët janë pas tyre”; “Lidhja mes shqiptarëve dhe krimit të dhunshëm dhe të organizuar – si trafikimi i qenieve njerëzore, zhatja dhe grabitja – është e padiskutueshme në të gjithë Evropën”, etj.
6-Vdekje	“Indianët e mallkuar (Indianet e leshit)”; “Ata janë aq të lezetshëm sa të digjen me vaj (Kastrati).”; “Vdektë dhe të marrë me vete gjithë racën serbe!”, etj.

11 Dosja.al (2021). ME VIDEO: Arian Curri nuk përmbahet: Ky është komb fshatarësh! Jemi republikë ‘kollovarësh’ - Politike (dosja.al)

Incidentet kanë ndodhur kryesisht në portalet informative, mediat tradicionale (televizionet dhe gazetatat) dhe mediat sociale. Përhapja e çdo medie ose postimi ndryshon në varësi të platformës ku publikohet përmbajtja, megjithatë, shumica e rasteve gjenden në portalet informuese, gjë që nxjerr në pah çështjen e “vetërregullimit”, ose më saktë, çështjen e mekanizmave vetërregullues të imponuar në mënyrë joefektive. Përhapja nuk ishte e mundur të gjurmohet për të gjitha incidentet, por në ato ku këto të dhëna ishin të disponueshme, u vu re se është aksesuar nga mijëra njerëz; për shembull, rasti i refugjatëve sirianë i publikuar në mediat sociale të JOQ (9,344 pëlqime)¹². Si rregull, sa më sensacionale, denigruese dhe negative të jetë përmbajtja, aq më e dukshme bëhet ajo, duke u përhapur shpejt dhe duke arritur një audiencë të gjerë derisa në disa raste bëhet virale.

3. Diskursi i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese me bazë gjininë

Sipas monitorimit, gjinia është grupi i dytë më i prekur nga gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese në median shqiptare. Padyshim që ka qenë gjithmonë një problem duke marrë parasysh mentalitetin patriarkal në të gjithë shoqërinë, i cili, zhvlerëson gratë dhe vajzat dhe legjitimon keqtrajtimin e tyre. Mediat tradicionale përforcojnë pikëpamjet tradicionale dhe stereotipet ekzistuese gjinore që janë të dëmshme për gratë dhe vajzat. Në edicionet e lajmeve, emisionet televizive dhe gazetatat, femrat përfaqësohen në media dhe përmes mediave thjesht si “të bukura”, “argëtuese”, “seksi” dhe “dekorative”, etj. Për shembull, në një konkurs kërcimi, njëra prej konkurrenteve, u vu në shënjestër të mizogjinisë së shprehur nga një anëtar i jurisë, i cili i thotë asaj:

“*...por që të garosh me këta të rinjtë...je në një moshë, më mirë martohu dhe bëj fëmijë.*”¹³

Është e rëndësishme të përmendet se gratë si grup bëhen lehtësisht subjekt i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese, megjithatë rastet tona tregojnë se gratë në industrinë e artit/muzikës, politikës dhe në veçanti gazetaret janë gjithashtu objektivi i raportimeve të papërshtatshme mediatike dhe gjuhës së urrejtjes.

Ka një fenomen interesant që ndodh, pasi audiencia nuk përqendrohet në përmbajtjen e artikullit të botuar, por fokusohet tek personi që përmendet në të. Duke anashkaluar përmbajtjen, ata fokusohen tek personi dhe jeta e tij/saj personale, shkelin etikën dhe privatësinë njëkohësisht duke shpërndarë gjuhë urrejtjeje dhe diskriminuese. Nga ana tjetër, media bën të njëjtën gjë, pasi merret me individin ose një rast specifik në vend që të analizojë problemin ose fenomenin si të tillë. Për shembull, pas një vrasjeje të ndodhur në Elbasan, mediat u fokusuan tek vajza e mitur, e cila u fajësua si motivi i vrasjes, në vend që ta analizonin situatën nga një këndvështrim më i gjerë. Këtu është një shembull i titujve në lidhje me rastin:

“*Kush ishte “molla” e sherrit që i mori jetën të riut në Elbasan; trupi i viktimës shtrirë në tokë, zbardhen pamjet e rënda.*”¹⁴

Fajësimi i viktimave është gjithashtu i pranishëm në mjedisin mediatik shqiptar. Për shembull, në rastet e abuzimit/ngacimit seksual dhe dhunës së kryer nga djemtë dhe burrat, media shpesh fajëson gratë ose vajzat e përfshira. Është për t'u habitur që fajësimi i viktimave mund të gjendet edhe tek profesionistët, siç ishte rasti i një avokateje, e cila në një dalje televizive u shpreh se arsyeja e rritjes së numrit të divorceve është se “gratë nuk e tolerojnë më dhunën”¹⁵ sikur të ishte përgjegjësi e grave për të toleruar dhe duruar dhunën, kur në fakt problemi/shkaku është vetë dhuna.

Përveç mediave tradicionale, një burim i madh i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese ndaj grave janë mediat/portalet informative dhe mediat sociale. Portalet e mediave online shpesh drejtohen nga klikimet dhe kjo shpjegon

¹² JOQ Albania (7 shtator 2021). Postim në Instagram. I disponueshëm në: https://www.instagram.com/p/CTg5JCqD6d6/?utm_medium=copy_link.

¹³ <https://youtu.be/hXr6Gx2j-8w>

¹⁴ Pamfleti (5 Nëntor 2021). “Kush ishte “molla” e sherrit që i mori jetën të riut në Elbasan; trupi i viktimës shtrirë në tokë, zbardhen pamjet e rënda”. E aksesueshme në: <https://pamfleti.net/kush-ishte-molla-e-sherrit-ge-i-mori-jeten-te-riut-ne-elbasan-trupi-i-viktimës-shtrirë-ne-toke-zbardhen-pamjet-e-rënda/>.

¹⁵ Top Channel (18 Prill 2022). “Pse po shtohen divorcet? Avokatja: Gratë nuk e durojnë më dhunën. I aksesueshëm në: <https://www.youtube.com/watch?v=KIDl67YRpd8>.

disi qasjen e tyre në prodhimin e përmbajtjes (që nuk mund të konsiderohet aspak lajm) që shet, duke përfshirë diskursin seksist dhe mizogjen, si edhe gjuhën e urrejtjes. Ka më shumë gjasa që një titull sensacionalist i kombinuar me tone seksiste të klikohet në krahasim me një titull të balancuar dhe informues.

Kur bëhet fjalë për motivet që nxisin gjuhën e urrejtjes dhe diskriminuese ndaj grave, nuk ka nevojë për ngjarje specifike, pasi është bërë normë dhe është pjesë e pandashme e përmbajtjes së përditshme mediatike. Megjithatë, titujt sensacionalistë të kombinuar me seksizmin dhe mizogjininë duket se janë një formulë që funksionon mjaft mirë me audiencën shqiptare, pasi prodhon gjithmonë urrejtje, gjë që sjell më shumë audiencë në diskutim. Gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese ndaj grave është normalizuar (duke qenë e pranishme haptazi në media dhe në këtë mënyrë audience ekspozohet vazhdimisht ndaj saj) dhe madje në disa raste bëhet vetë gratë kundër njëra-tjetrës.

Bazuar në analizën sentimentale, rezultati mesatar i intensitetit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese ndaj grave është më i larti krahasuar me dy kategoritë e tjera, duke arritur në 3.8. Pothuajse në nivelin 4, kjo tregon një diskurs intensiv, që përfshin narrativa që demonizojnë dhe çnjerëzojnë gratë dhe vajzat. Tabela më poshtë tregon disa shembuj të tregimeve që u gjetën në incidentet e raportuara.

Niveli	Gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese - Gjinia
1-Mosmarrëveshje	–
2-Veprime negative	“I moshuar dhe jo i përshtatshëm për të konkurruar në një konkurs kërcimi me të rinj.”; “Shko bëj fëmijë.”; Çmendet nusja, bën Twerk të shoqit para të ftuarve pothuajse lakuriq” etj.
3-Karakter/Personazh negativ	“Ju jeni homoseksual sepse ndiqni vetëm burra të zhveshur në Instagram”; “Ti je njeriu më i pafuqishëm”; “Degenerative për shoqërinë”; “i paarsimuar”; “Nuk e njeh konceptin e familjes”; “Injorant”; “Copa mishi, injorant”; “Çfarë ka më pas, a duhet të përfshijmë edhe gratë në ndërtim dhe miniera?”, etj.
4-Demonizimi & çnjerëzim	“Arjan/a Konomi; ai dhe falangat e tij; Arjan Konomi dhe imoraliteti.”; “Huligan, njeri i shpellave, plagjiaturë; njeri i sëmurë; hiena e plagosur; shkarravin, i shëmtuar/njeri shkarravinë etj.”; “Gridare, gridare, gridare ohoho”; “Një kult”; “Për të promovuar homoseksualitetin si vlerën e madhe të shoqërive të përparuara”; “mutantët”; “Këngëtare cigan që nuk është as shqiptare,” “Ajo e ka shkruar tekstin e këngës duke bërë seks”; “Lopë holandeze”; “gomari shqiptar” etj.
5-Nxitja e dhunës	“Po të ishim në Shqipëri do të të kisha rrahur keq”; “A ju femrave feministe nuk ju pëlqen t’i godasin në prapnicë? Janë të shumta komentet nga të frustruarat, femrat, femrat e nderuara, “virgjëreshat”, për të pasmet e vajzave, që këto femra nuk mund t’i kishin kurrë...”); “Ajo braktisi 2 fëmijët e saj për të shkuar te i dashuri i saj.”; “Gratë janë të çmendura, e kanë gjetur fjalën “më kanë keqtrajtuar”: je keqtrajtuar se ke qenë keq...”, etj.
6-Vdekje	“Kapini ata pedofilë që keni në Gjermani. Ju keni numrin më të madh të pedofilëve dhe këto lloj racash mbrohen shumë. Ju po e ktheni botën përmbys. Zoti të vratë.”

Burimet e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese kundër grave janë në shumicën e rasteve gazetarët/mediat për arsyet e lartpërmendura, të ndjekur nga personazhet e famshëm, individët (audiencia online) dhe politikanët. Këto incidente janë të zakonshme dhe mund të shihen në TV, gazeta, portale online dhe media sociale. Ngjashëm me gjuhën e urrejtjes dhe diskriminuese kundër përkatësisë etnike, narrativat e papërshtatshme ndaj grave dhe vajzave shprehen si verbalisht (në formë të folur ashtu edhe në të shkruar) dhe vizualisht (audio/video dhe imazhe).

Vizibiliteti dhe përhapja e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese ndaj grave është mjaft mirë e mbuluar, siç dëshmohet nga fakti se një incident arrin të paktën 13,000 njerëz përmes platformave të mediave sociale, duke demonstruar ekspozimin e përmbajtjeve të tilla dhe angazhimin e publikut, i cili në përgjithësi është mbështetës i dhunës, urrejtjes, seksizmit dhe mizogjinisë. Ky është një sinjal alarmi, që nxjerr në pah nevojën për të edukuar audiencën në lidhje me gjuhën e urrejtjes dhe ndikimin e saj në shoqëri, e veçanërisht ndaj grave dhe vajzave.

4. Diskursi i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese me bazë orientimin seksual

Grupi i tretë më i shënjestruar sa i përket përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese në mjedisin mediatic është komuniteti LGBTQ+. Shqipëria ka bërë progres në drejtim të integritit dhe pranimit të personave LGBTQ+ në shoqëri, por pavarësisht kësaj gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese ndaj komunitetit mbetet e zakonshme në media. Procesi i “tjetërzimit” të komunitetit në fjalë është veçanërisht i dukshëm, sidomos në kontekstin e reagimeve të ndryshme për shkak të ndryshimeve të propozuara në legjislacion, që synojnë ta bëjnë komunitetin më të barabartë në shoqëri.

Gjegjësisht, shumica e incidenteve ndodhën në kontekstin e propozimit për të zëvendësuar termat “nënë” dhe “baba” në forma zyrtare, me termat “prindi 1” dhe “prindi 2” për një qasje më të barabartë ose gjithëpërfshirëse në terma ligjorë. Kështu, narrativa kryesore e identifikuar në raportim përfshin kërcënimin e perceptuar që komuniteti LGBTQ+ paraqet për nocionin e familjes, një koncept thelbësor në shoqërinë dhe traditën shqiptare.

Duke filluar nga qershori 2021, gjuha e urrejtjes kundër komunitetit LGBTQ+ u shpreh në tituj në pothuajse të gjitha mediat për shkak të një mosmarrëveshjeje tashmë të njohur me pastorin ungjillor, Akil Pano¹⁶, i cili kryeson Koalicionin Shqiptar për Mbrojtjen e Familjes. Pano u raportua nga Aleanca LGBTQ+, organizata kryesore në Shqipëri e dedikuar për mbrojtjen e të drejtave të LGBTQ+, tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pas komenteve të urrejtjes në emisione të ndryshme televizive dhe dalje publike. Pano, i cili është pozicionuar në ballë të luftës kundër ndryshimeve të sipërpërmendura në legjislacion, vazhdimisht flet për rreziqet e “Axxhendës Gay”, duke bërë deklarata në të cilat e cilëson homoseksualitetin si një devijim dhe për rrjedhojë e konsideron mundësinë e adoptimit dhe prindërimit të fëmijëve nga homoseksualët “veprim kriminal”. Me tej akoma e krahason homoseksualizmin me kafshët:



“Me legalizimin e martesave hiqet steka morale. Që do të thotë që çdo njeri mund të vijë dhe të kërkojë martesën dhe me një kafshë, mund të kërkojë edhe martesën treshe, katërshe.... Nuk ka më kufi.”¹⁷

Në nëntor 2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi në favor të Aleancës LGBTQ+, duke deklaruar se Pano kishte përdorur gjuhën e urrejtjes kundër komunitetit LGBTQ+: “Pikëpamjet dhe qëndrimet e shprehura nga A.P. janë përtej lirisë së shprehjes dhe lirisë së shprehjes së fesë dhe besimit...”.

Megjithatë, sulmet ndaj komunitetit LGBTQ+ në Shqipëri nuk janë kufizuar vetëm në gjuhën e urrejtjes dhe diskriminuese, por kanë përfshirë edhe përpjekje për dezinformim apo manipulim informacioni. Në fund të tetorit, Pano raportoi në faqen e tij në Facebook për ekzistencën e një formulari të shpërndarë në një kopsht fëmijësh në Tiranë, ku termat “nënë” dhe “baba” në fakt zëvendësoheshin me “prindin 1” dhe “prindin 2” në kundërshtim me Kodin Shqiptar të Familjes. Ky incident u raportua më vonë negativisht nga disa media dhe portale që e konsideruan atë “të turpshëm”¹⁸. Zyrtarët publikë përkatës trajtuan polemikën, duke pohuar se Bashkia e Tiranës qarkullon vetëm formularët e regjistrimit në përputhje me Kodin e Familjes dhe shtuan se formulari i raportuar nga Pano dukej si një pyetësor për një disertacion. Aleanca LGBTQ+ u përgjigj duke dënuar median për mungesën e profesionalizmit të saj në nxitimin për të raportuar mbi çështjen e formularit:



“Kërkojmë nga media dhe gazetarët të distancohen nga kjo praktikë e papranueshme dhe të luajnë rolin e tyre investigues e informues, të pavarur dhe të pandikuar, në vend që të kthehen në burim keqinformimi dhe shpifjeje, duke na përballur padrejtësisht e për të disatën herë me valë të stisura urrejtjeje.”¹⁹

16 Klan TV (18 Qershor 2021). “Pastori Akil Pano: Komuniteti LGBT përdor gjuhe shantazhi”. I aksesueshëm në: <https://www.youtube.com/watch?v=56uukpnhh80>.

17 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (2021). Vendimi nr. 217, datë 15.11.2021. I aksesueshëm në: <https://kmd.al/wp-content/uploads/2022/01/Vendim-nr-217-date-15.11.2021-Ceshtje-kryesisht-nga-Komisioneri-ne-lidhie-me-gjuhen-e-perdorur-kunder-personave-LGBTI-Diskriminim-Gjuhe-urrejtje.pdf>.

18 Priza.al (Tetor 2021). “Ngjarja e turpshme në kopshtet e Tiranës/ Fjala ‘mami’ dhe ‘babi’ zëvendësohen me ‘prindi 1’ e ‘prindi 2!’ I aksesueshëm në: <https://www.priza.al/2021/10/27/ngjarja-e-turpshme-ne-kopshtet-e-tiranes-fjala-mami-dhe-babi-zevendesohen-me-prindi-1-e-prindi-2/>.

19 Aleanca LGBT (28 Tetor 2021). Njoftim përr Mediat. I aksesueshëm në: <https://www.instagram.com/p/CVxkllmtZx2/>.

Ndërsa mosmarrëveshja e vazhdueshme midis komunitetit LGBTQ+ dhe pastorit Akil Pano dominonte mjedisin mediatik në lidhje me HDD-në kundër këtij komuniteti, janë vërejtur narrativa të tjera, veçanërisht në lidhje me pandeminë COVID-19 dhe përhapjen e vaksinave. Kështu, një titull thotë:



*“Deklarata shokuese për vaksinën e koronavirusit:
Mund t’i kthejë njerëzit në homoseksualë”²⁰*

Përtej pranisë së gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese ndaj komunitetit, analiza sentimentale, tregon një nivel relativisht të ulët të intensitetit (2.1), duke mbetur në nivelin e retorikës që nuk kërkon dhunë kundër grupit. Megjithatë, disa incidente paraqitën një nivel të lartë intensiteti (5), si në raportimin për sulmin e një aktivisteje transgjiniore 21-vjeçare në Tiranë në qershor 2021²¹.

Niveli	Gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese – Orientimi seksual
1-Mosmarrëveshje	“Deklaratë shokuese për vaksinën kundër Coronavirus: Ajo mund t’i bëjë njerëzit homoseksualë”; “Fëmija do të mendojë se homoseksualiteti është krejtësisht normal; do të shkojë në shkollë dhe do të puthë shokun e klasës sepse i pëlqen shumë.”; “Axhenda e homoseksualëve ka filluar të zbatohet me qetësi dhe në kundërshtim me Kodin e Familjes në fuqi në Shqipëri”.
2-Veprime negative	“Bekoni Enver Hoxhën për ndalimin e burrave homoseksualë në burgun e grave për shkak të frikës se mos infektonte burra të tjerë në burgjet e burrave.”
3-Karakter/Personazh negativ	“Është një fatkeqësi e madhe [që një person LGBTQ] lind një fëmijë.”; “Më parë shqiptarët përfaqësoheshin nga burrat, tani përfaqësohen nga pedera.”; “Më vjen shumë keq që i quani këta njerëz artistë, ky është thjesht një person i sëmurë mendor.”
4-Demonizimi & çnjerëzim	–
5-Nxitja e dhunës	“Aktivistja Xheni Karaj denoncon: 21-vjeçari shqiptar sulmohet dhe dhunohet nga 10 djem/ Publikon shenja në trup”.
6-Vdekje	–

Ndërsa titujt paragjykes dhe të njëanshëm janë të pranishëm në mediat tradicionale kryesore, titujt më sensacionalë lulëzojnë në mediat online, duke u dhënë hapësirë përdoruesve të shprehin ndjenjat e tyre të urrejtjes në seksionet e komenteve. Këtu duhet theksuar roli i JOQ Albania në përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese.

Ky portal është pozicionuar me një linjë editoriale anti-LGBTQ+, duke qenë media me incidentet më të raportuara të gjuhës së urrejtjes kundër këtij grupi. Edhe pse kjo linjë editoriale nuk është shprehur hapur, duket qartë për lexuesin duke marrë parasysh gjuhën dhe madje edhe imazhet që përdoren. Në një shembull të spikatur, platforma raportoi negativisht për komentet e Hoxhë Shefqet Krasniqit në lidhje me mosmiratimin nga Parlamenti i Kosovës për ndryshimin e propozuar në Kodin Civil për të përfshirë martesat LGBTQ+ nën titullin:



*“Mosmiratimi i Kodit të Homoseksualëve/ Hoxhë Shefqet Krasniqi:
Shpëtuam nga hidhërimi i të madhit Zot!”²²*

Për më tepër, imazhi shoqëruar përfshinte hoxhën së bashku me një fotografi të dy burrave duke u puthur, njëri prej tyre duke mbajtur një libër, duke sugjeruar se mund të ishte një libër fetar. Duhet theksuar se imazhet janë kyçe, pasi përdoruesit, veçanërisht në Instagram, reagojnë negativisht ndaj imazheve dhe shprehin pikëpamjet e tyre negative në seksionin e komenteve duke përdorur gjuhë urrejtjeje dhe diskriminuese.

20 Top Channel (18 Janar 2021). “Deklarata shokuese për vaksinën e koronavirusit: Mund t’i kthejë njerëzit në homoseksualë”. I aksesueshëm në: https://top-channel.tv/2021/01/18/ddeklarata-shokuese-per-vaksinën-e-koronavirusit-mund-ti-ktheje-njerëzit-ne-homoseksuale/?fbclid=IwAR2ND3lSX2ZcpCnpOrmna_mAi8kl_DUDX0xrMGGc58abown_f5S2vRplr7o.

21 Top Channel (16 Qershor 2021). “Aktivistja Xheni Karaj denoncon: 21-vjeçarja shqiptare sulmohet e dhunohet nga 10 djem/ Publikon shenjat në trup”. I aksesueshëm në: <https://top-channel.tv/2021/06/16/aktivistja-xheni-karaj-denoncon-21-vjeçarja-shqiptare-sulmohet-e-dhunohet-nga-10-djem-publikon-shenjat-ne-trup/?foto=3#g>.

22 JOQ Albania (18 Mars 2022). “Mosmiratimi i Kodit të Homoseksualëve/ Hoxhë Shefqet Krasniqi: Shpëtuam nga hidhërimi i të madhit Zot!” I aksesueshëm në: <https://joq-albania.com/artikull/995749.html>.



Analizë krahasuese

Diskursi i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese mund të ndryshojë rast pas rasti, megjithatë, pavarësisht nga dallimet ndërmjet rasteve dhe kategorive, ne kemi identifikuar disa karakteristika të përbashkëta mes tyre.

Së pari, diskursi i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese bëhet në bazë të paragjytimeve, stereotipave dhe klisheve në lidhje me gjininë, përkatësinë etnike, fenë, orientimin seksual ose personat me aftësi të kufizuara. Këto narrativa ekzistuese të dëmshme përforcohen dhe mbahen të gjalla për të “legjitimuar” gjuhën e urrejtjes dhe diskriminuese që media dhe audienca përdor, me qëllim për ta kthyer atë në diçka të normalizuar, të përhapur gjerësisht dhe të pranuar.

Së dyti, vihet re se një grup i tërë bëhet objektiv i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese, edhe kur akti është individual. Gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese e përgjithësuar kryhet kundër grave, për shkaqe etnike dhe ndaj pakicave. Përgjithësimet e gabuara janë të pranishme në portretizimin ose pasqyrimin e “tjetrit” ose të atij që është i ndryshëm apo që ka mendime të ndryshme.

Së treti, gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese nxitet nga një qasje sensacionale në raportimin për gratë, pakicat seksuale, përkatësinë etnike, fenë, migrantët/refugjatët, etj. Titujt e tillë tërheqin audiencën dhe e frymëzojnë atë të përhapë gjuhë urrejtjeje dhe diskriminuese vetëm në bazë të titullit, pa lexuar as përmbajtjen. Gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese gjithashtu mund të synojë personin që përmendet në lajm, madje edhe duke ndërhyrë në jetën e tij/saj personale, duke shkelur kështu privatësinë.

Së katërti, gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese vjen e kombinuar me elementë verbalë (të shkruar dhe të folur) dhe vizualë (video, imazhe, meme). Në mënyrë të veçantë, në rrjetet sociale shoqërohet me humor përmes memeve dhe batutave, ndërsa në portalet e lajmeve shoqërohet me imazhe apo video të papërshtatshme, sensacionale, jashtë kontekstit apo edhe në shkelje të të drejtave të njeriut.

Nga ana tjetër, kemi vërejtur disa dallime ndërmjet rasteve dhe kategorive. Gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese ndryshon ndjeshëm në varësi të burimeve që e prodhojnë atë. Ka burime të ndryshme, zakonisht më shumë se një për kategori, duke kombinuar gazetarë dhe personel mediatik, figura politike, figura publike, influencers dhe individë (anëtar i audiencës). Është e rëndësishme të sqarohet se gazetarët nuk janë në të gjitha rastet përgjegjës

të drejtpërdrejtë për prodhimin e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese, por ata e përhapin atë dhe e bëjnë të dukshme, në të njëjtën kohë duke mbetur “të fshehur” pas autorit/ve duke “cituar atë që u tha” dhe duke e bërë atë një titull, pavarësisht urrejtjes që përmban.

Përmbajtje të ndryshme të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese shpërndahen në platforma ose media të ndryshme; megjithatë, ajo që transmetohet në TV publikohet edhe në gazeta, portalet informuese online dhe mediat sociale. Përhapja e një rasti, logjikisht mund të përkeqësohet pasi incidentet mund të shpërndahen përmes disa platformave të ndryshme. Mediat sociale luajnë një rol kyç në bërjen virale të rasteve të tilla të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese, si edhe argëtimin e një publiku që ushqehet me një përmbajtje të tillë, duke e bërë atë pjesë të diskursit të përditshëm.

Së fundmi, fenomeni i “heshtjes së urrejtjes” nuk mund të anashkalohet. Diskursi i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese në mjedisin mediatic, por edhe krimet kundër grupeve dhe pakicave të caktuara, përkatësisht ndaj komunitetit rom dhe egjiptian në Shqipëri, nuk raportohen për shkak të mosinteresimit publik dhe për shkak të tjetërsimit të këtyre komuniteteve nga shoqëria.

Nismat kombëtare për luftën kundër gjuhës së urrejtjes

Në nivel kombëtar, veprimet e ndërmarra kundër gjuhës së urrejtjes nuk janë as të përhapura dhe as të qëndrueshme. Megjithatë, ka disa nisma të ndërmarra nga aktorë të ndryshëm, duke përfshirë institucionet publike, autoritetet mediatike, organizatat e medias dhe organizatat e shoqërisë civile.

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), përmes Këshillit të Ankesave, synon t'i përgjigjet gjuhës së urrejtjes dhe përmbajtjes joetike të publikuar nga mediat audiovizive; megjithatë, ndikimi i një veprimi të tillë mbetet ende për t'u parë, sepse seksizmi, mizogjia dhe gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese janë ende të pranishme në programe të ndryshme televizive, megjithëse jo aq shumë krahasuar me mediat online dhe ato sociale.

Në vitin 2019, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Autoriteti i Medias Audiovizive dhe Këshilli Shqiptar i Medias krijuan Aleancën Kundër Gjuhës së Urrejtjes²³ me synimin për të trajtuar gjuhën e urrejtjes “në të gjitha dimensionet” në të cilat ajo shfaqet në shoqëri, me një fokus të veçantë në gjuhën e urrejtjes në internet. Përsëri, përkundër këtyre përpjekjeve të përbashkëta, situata nuk është përmirësuar dukshëm vitet e fundit.

Nga ana tjetër, ka disa organizata mediatike dhe OSHC që përpiqen të adresojnë gjuhën e urrejtjes përmes projekteve dhe nismave të ndryshme, si p.sh. përmes trajnimit të gazetarëve; megjithatë, këto përpjekje janë sporadike, afatshkurtra dhe kanë pak ndikim ose shtrirje të kufizuar.

²³ Avokati i Popullit (2019). “Aleanca Kundër Gjuhës së Urrejtjes.” I aksesueshëm në: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/Memorandumem-marreveshje/aleanca-kundër-gjuhës-së-urrejtjes-517/>.



Përfundime

Në fokus të monitorimit për këtë raport ishin incidentet që përmbanin gjuhë urrejtjeje dhe diskriminuese të lidhura me gjininë, përkatësinë etnike, fenë, pakicat seksuale, migrantët/refugjatët, etj. Incidentet kanë ndodhur në mediat tradicionale, të reja dhe sociale.

Gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese ka qenë më e përhapur ndaj grupeve, individëve dhe komuniteteve për shkak të përkatësisë etnike (38.5%), gjinisë (20.5%) dhe orientimit seksual (12%).

Sipas analizës sentimentale, intensiteti i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese arrin rezultatin mesatar në nivelin 3. Kjo do të thotë se ashpërsia e diskursit është e ndërmjetme dhe karakterizohet nga narrativa fyese, ofenduese, por jo të dhunshme. Megjithatë, kjo nuk e pakëson ndikimin negativ që këto narrativa përçarëse kanë tek individët, grupet dhe komunitetet e prekura, si edhe në të gjithë shoqërinë.

Media kontribuon në këtë diskurs të dëmshëm duke përforcuar paragjykimet etnike, duke shkruar tituj që një cënojnë një grup të tërë etnik edhe kur është vetëm një individ i përfshirë, si dhe duke raportur ngjarjet në mënyrë sensacionale. Media kontribuon në mënyrë të barabartë në përjetësimin e narrativave seksiste dhe mizogjene në shoqëri, si dhe në “tjetërzimin” e komunitetit LGBTQ+. Ngjashëm me mediat tradicionale, ashtu edhe ato online mbajnë barrën e krijimit, përhapjes dhe mosfiltrimit të diskursit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese, megjithatë janë mediat online, duke përfshirë versionet online të këtyre mediave tradicionale, ku urrejtja lulëzon përmes seksioneve të komenteve.

Për herë të parë, etnia del si kategoria më e prekur nga gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese në Shqipëri. Kjo është padyshim për shkak të ngjarjeve në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe nga pandemia COVID-19. Megjithatë, gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese ndaj grave dhe vajzave arrin nivele më të larta të intensitetit, gjë që nxjerr në pah një perceptim negativ ndaj grave dhe vajzave, të rrënjosur thellë në shoqëri, që përjetësohet lehtësisht përmes mediave. Po kështu, gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese ndaj komunitetit LGBTQ+ është e pranishme, veçanërisht në mediat online.

Referenca

- AMI (2022). Mind the language. Përmbledhje e projektit. E disponueshme online në: <https://www.annalindhfoundation.org/sites/default/files/documents/network-news/Mind%20the%20Language%20-%20Project%20Handbook.pdf>
- Aleanca LGBT (28 Tetor 2021). Njoftim për median. E disponueshme online në: <https://www.instagram.com/p/CVklmtZX2/>.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (2021). Vendimi nr. 217, data 15.11.2021. E disponueshme online në: https://kmd.al/wp-content/uploads/2022/01/Vendim-nr-217-date-15.11.2021-Ceshtje-kryesisht-nga-Komisioneri-ne-lidhje-me-gjuhen-e-perdorur-kunder-personave-LGBTI-Diskriminim_Gjuhe-urrejtje.pdf.
- Dosja.al (11 Maj 2021). "ME VIDEO: Arjan Curri nuk përmbahet: Ky është komb fshatarësh! Jemi republikë 'kollovarësh'". E disponueshme online në: <https://dosja.al/me-video-arjan-curri-nuk-permbahet-ky-eshte-komb-fshataresh-jemi-republike-kollovaresh/>
- Gazeta Telegraf (16 Shtator 2021). "Bota po mbyll kufijtë, Shqipëria "han pa porta". E disponueshme online në: <https://telegraf.al/politike/bota-po-mbyll-kufijte-shqiperia-han-pa-porta/>
- Universiteti "Xhorxh Uashington" (2019). Monitorimi i gjuhës së urrejtjes në mediat amerikane. Artikull. Projekti për median dhe krijimin e paqes, faqja 5. E disponueshme online në: https://www.historyofhate.org/wp-content/uploads/2019/05/Monitoring-Hate-Speech-in-the-US-Media-3_22-2019.pdf
- Historia Ime (2021). Monitorimi i Gjuhës së Urrejtjes, diskriminuese dhe seksiste në mediat online dhe televizion. E disponueshme online në: <https://www.historyofhate.org/wp-content/uploads/2021/05/Media-Monitoring-Discrimination-and-Sexism-2021.pdf>
- JOQ Albania (7 Shtator 2021). Instagram post. E disponueshme online në: https://www.instagram.com/p/CTg5JCqD6d6/?utm_medium=copy_link
- JOQ Albania (18 Mars 2022). "Mosmiratimi i Kodit të Homoseksualëve/ Hoxhë Shefqet Krasniqi: Shpëtuam nga hidhërimi i të madhit Zot!" E disponueshme online në: <https://joq-albania.com/artikull/995749.html>.
- Klan TV (18 qershor 2021). "Pastori Akil Pano: Komuniteti LGBT përdor gjuhë shantazhi". E disponueshme online në: <https://www.youtube.com/watch?v=56uukphh80>.
- OSFA, ISHM (AMI). Priret e gjuhës së urrejtjes në median shqiptare. Një monitorim i disa mediave të shkruara dhe online. E disponueshme online në: https://www.osfa.al/sites/default/files/monitorimi_per_gjuhen_e_urrejtjes_ne_gazeta_dhe_media_online_3.pdf
- Pamfleti (5 Nëntor 2021). "Kush ishte "molla" e sherrit që i mori jetën të riut në Elbasan; trupi i viktimës shtrirë në tokë, zbardhen pamjet e rënda". E disponueshme online në: <https://pamfleti.net/kush-ishte-molla-e-sherrit-qe-i-mori-jeten-te-riut-ne-elbasan-trupi-i-viktimes-shtrire-ne-toke-zbardhen-pamjet-e-renda/>
- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (2021). Ligji Nr. 79/2021 për të huajt. E disponueshme online në: <https://www.parlament.al/Files/Akte/2021070817284820210705135531ligj%20nr.%2079%20dt.%2024.6.2021.pdf>
- Avokati i Popullit (2019). "Aleanca Kundër Gjuhës së Urrejtjes." E disponueshme online në: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/Memorandum-marreveshje/aleanca-kundr-gjuhs-s-urrejtjes-517/>.
- Priza.al (Tetor 2021). "Ngjarja e turpshme në kopshtet e Tiranës/ Fjala 'mami' dhe 'babi' zëvendësohen me 'prindi 1' e 'prindi 2!'". E disponueshme online në: <https://www.priza.al/2021/10/27/ngjarja-e-turpshme-ne-kopshtet-e-tiranes-fjala-mami-dhe-babi-zevendesohen-me-prindi-1-e-prindi-2/>.
- TemA (22 Shkurt 2021). "Pacienti me COVID në Sanatorium: Më mirë të vdesësh nga Zoti, se sa nga ata qen bir qensh, kinezët". E disponueshme online në: <https://www.gazetatema.net/2021/02/24/pacienti-me-covid-ne-sanatorium-me-mire-te-vdesesh-nga-zoti-se-sa-nga-ata-qen-bir-qensh-kinezet/>
- Top Channel (18 Janar 2021). "Deklarata shokuese për vaksinën e koronavirusit: Mund t'i kthejë njerëzit në homoseksualë". E disponueshme online në: https://top-channel.tv/2021/01/18/1deklarata-shokuese-per-vaksinene-e-koronavirusit-mund-ti-ktheje-njerezit-ne-homoseksuale/?fbclid=IwAR2ND3ISX2ZcpCnpOrmna_mAi8kl_DUDX0xrMGc58abown_f5S2vRpl7o.
- Top Channel (16 Qershor 2021). "Aktivistja Xheni Karaj denoncon: 21-vjeçarja shqiptare sulmohet e dhunohet nga 10 djem/ Publikon shenjat në trup". E disponueshme online në: <https://top-channel.tv/2021/06/16/aktivistja-xheni-karaj-denoncon-21-vjecarja-shqiptare-sulmohet-e-dhunohet-nga-10-djem-publikon-shenjat-ne-trup/?foto=3#g>.
- Top Channel (18 Prill 2022). "Pse po shtohen divorcet? Avokatja: Gratë nuk e durojnë më dhunën". E disponueshme online në: <https://www.youtube.com/watch?v=KIDl67YRpd8>.



RAPORT MONITORIMI PËR GJUHËN E URREJTJES NË SHQIPËRI



Funded by
the European Union



The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

